

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE
NOTER PUBLIK DUSHO H.DUSHA**

Nr. 1082 Rep.
Nr. 740/4 Kol.



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Ne Tirane, sot me daten 05.04.2007(dymije e shtate), ne zyren noteriale, rruga "Reshit Çollaku", Pall."Shallvare", Nr.41, Tirane, para meje noterit Dusho Dusha, palet meposhteme ne baze te nenit 705 e vijues te Kodit Civil si dhe te Ligjit "Per shoqerite tregtare", kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje si vijon :

SHITES:

1.Bashkim Hoxha, i biri i Dalipit, lindur ne Elbasan, banues ne Durres, rruga "Taulantia", Nr.1, i datelindjes 02.02.1954, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr.Z0652404,

2.Gezim Domi, i biri i Aliut, lindur dhe banues ne Durres, rruga "Taulantia", Nr.1, i datelindjes 27.12.1959, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr.Z1606713,

BLERES:

1.Astrit Veliqaj, i biri i Ferikut, i datelindjes 08.04.1958, lindur dhe banues ne Tirane, rruga "H.Hidri", Nr.58/1, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar me pasaporten Nr.S0001098,

OBJEKTI dhe BAZA LIGJORE:Transferimi i kuotave te shoqerise "RTV TEUTA " shpk, qe i perkasin Ortakeve Bashkim Hoxha dhe Gezim Domi ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", neneve 62,63 dhe neneve 16 dhe 17 te statutit te shoqerise "RTV TEUTA "shpk .

PERMBAJTJA E KONTRATES

Shoqeria " RTV TEUTA " shpk, eshte regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane, me vendimin Nr.22013, date 24.09.1999.

Sipas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur deri ne ditën e sotme te dy ortaket Bashkim Hoxha dhe Gezim Domi zoterojne 100(njeqind)perqind te kuotave ne shoqerine « RTV TEUTA »shpk, ku seicili zoteron nga 50(pesedhete)perqind te kuotave.



Me vendimin Nr.22013/2, date 12.10.2000 te Gjykates se Rrethit Tirane, shoqeria « RTV TEUTA » shpk, ka nje kapital te regjistruar ne vleren 25.283.924(njzet e pesemilion e dyqind e tetedhete e tremije e nenteqind e njzet e kater) leke.

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", nenit 62,63 dhe neneve perkates te statutit te shoqerise "RTV TEUTA" shpk, shitesit dhe bleresi bien dakord ndermjet tyre per shitjen e kuotave si me poshte vijon:

Me vendimin Nr.3, date 05.04.2007 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise « RTV TEUTA » shpk, eshte vendosur shitja ne masen 100(njeqind)perqind te kuotave te shoqerise « RTV TEUTA »shpk.

Bashkim Hoxha dhe Gezim Domi zoterojne 100(njeqind) perqind te kuotave te kapitalit te cilat i shiten Astrit Veliaj ne masen 100(njeqind) perqind te kuotave te kapitalit ne vleren 15.000.500(pesembedhete milion e peseqind mije) leke, blerje kjo qe pranohet te behet nga ana e Astrit Veliaj, i cili deklaroi se eshte dakord per blerjen e kuotave te ortakeve Bashkim Hoxha dhe Gezim Domi qe ata zoterojne ne shoqerine « RTV TEUTA »shpk, ne vleren 15.000.500(pesembedhete milion e peseqind mije) leke .

Perfundimisht, pas ketij trasaksioni shitje dhe blerje Bashkim Hoxha dhe Gezim Domi nuk do te zoterojne ne te ardhmen asnje kuote ne shoqerine "TEUTA RTV" shpk dhe Astrit Veliaj behet pronar i vetem duke zoteruar 100(njeqind)perqind te kuotave ne shoqerine "RTV TEUTA " shpk.

Ne kete shitje perfshihen te gjitha paisjet dhe aparaturat e shoqerise « RTV TEUTA »shpk, sipas lidhjes Nr.1, (flete tre), bashkelidhur e cila eshte pjese perberese e kesaj kontrate.

Nga ky moment Astrit Veliaj merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga administrimi i kesaj shoqerie.

Pagesa ne shumen e mesiperme eshte bere jashte zyres noteriale dhe ne menyren e pageses per te cilen te dyja palet kane rene dakord ndermjet tyre.

Shpenzimet noteriale, te avokatit dhe ato te depozitimit te akteve ne gjykate, do te perballohen ne menyre te barabarte nga te dyja palet.

Kontrata hartohet ne pese kopje te njejta, nga te cilat nje e mbajne palet, nje kopje depozitohet ne Zyren e Regjistrimit Tregtar, nje kopje depozitohet ne aktet e shoqerise dhe nje kopje prane noterit ku ajo u redaktua.

Termat e kontrates, pasi u redaktuan prej meje noterit, iu bene te njohura paleve kontraktuese, te cilet e nenshkruan ate me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ne pranine time.

SHITESIT

Bashkim Hoxha

Bashkim Hoxha

Bashkim Hoxha

Gezim Domi

Gezim Domi

Gezim Domi

BLERESI

Astrit Veliaj

Astrit Veliaj

Astrit Veliaj

**NOTER
DUSHO DUSHA**

Dusho Dusha